



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**

Departamenti i Biologjisë

Agnesa Krasniqi

Titulli i punimit:

**FLORA VASKULARE PËRGJATË RRJEDHËS SË LUMIT
MIRUSHË (BLLACË-MIRUSHË)**

Punim i Masterit

Prishtinë, 2025



UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF MATHEMATICAL-NATURAL SCIENCES
Department of Biology

Candidate:

Agnesa Krasniqi

Title:

**Vascular flora along the flow of the Mirusha river
(Bllacë-Mirushë)**

Master Thesis

Prishtinë, 2025



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMETIKE-NATYRORE
Departamenti i Biologjisë

Kandidat:

Agnesa Krasniqi

Titulli i punimit:

**Flora vaskulare përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë
(Bllacë-Mirushë)**

Punim i Masterit

Mentor:

Prof. Dr. Elez Krasniqi

Prishtinë, 2025

11.REZYME

Republika e Kosovës, përfshirë pellgun e lumit Mirushë ku bënë pjesë zonsa e hulumtuar në këtë punim të masterit, edhe pse, sipërfaqe e vogël ka diversitet të pasur bimor. Ky diversitet floristik luan rol të rëndësishëm në kuadër të ekosistemeve të Kosovës.

Pothuajse në qendër të zones së këtij hulumtimi gjendet qyteza e Malishevës. Kjo qytezë është njëherit një qendër të rëndësishme administrative, ekonomike, dhe kulturore ndërsa gjendet në nyjën rrugore Rahovec-Prishtinë-Duhle-Klinë. Me sipërfaqe prej rreth 306.3 km² e përbërë nga qyteza e Malishevës dhe 44 fshatra, territori i komunës së Malishevës karakterizohet nga tokat bujqësore pjellore me ara, livadhe e kullosa, pyje, dhe me tokë djerrinë (Osmani, J. 2006, Islami, H. 2018). Pothuaj se përmes qytezës dhe territorit administrativ komunal kalon rrjedha e lumit Mirushë e cila është hulumtuar në kuadër të këtij hulumtimi si punim i masterit.

Sa i përket mesatareve të temperaturave të ajrit dhe reshjeve, temperaturat mesatare vjetore e ajrit është rreth 11.2⁰C, ndërsa reshjet mestare vjetore arrijnë 684 mm. Klima është mesatare kontinentale. Gjeologjia dhe pedologjia përbëhen nga shkëmbinjë dhe toka të tipeve të ndryshme (Osmani, J. 2006, Çavolli, R. 1997, Islami, H. 2018, Zogaj, I. 2010, Rexhepi, F. 1994, Krasniqi, E. 2003, 2006).

Lumi, një pjesë e të cilit është hulumtuar në këtë rast (Bllacë-Mirushë), buron afë vendbanimit Bllacë, në shpatet perëndimore të Malit Drenicë, ndërsa vazhdon rrejdhën duke kaluar nëpër territorin kadastral të vendbanimeve Bllacë, Temeqinë, Bellanicë, Banjë, Malishevë dhe Mirushë si zone për hulumtim në rastin tone; ndërsa lumi vazhdon rrjedhën e tij duke kaluar nëpër territorin administrativ të vendbanimeve tjera si Lubizhdë, Turjakë, Damanek-Bubël, Dush i Vogël-Panorc, Dush i Vogël-Llapçevë, Llapçevë-Volljak dhe Volljak-Mrasor. Në vazhdimësi të rrjedhës së tij,

lumi Mirushë shkarkohet në lumin Drini i Bardhë në zonën e fundit të rrjedhës së tij duke kaluar nëpër zonat kadastrale Mrasor-Volljakë.

Ky hulumtim kishte për qëllim studimin e florës vaskulare përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë nga Bllaca deri në Mirushë). Pasi që lumi Mirushë (Bllacë-Mirushë) e përfaqëson një segment të rëndësishëm ekologjik pëllgun e lumit Mirushë, atëherë rezultatet e këtij hulumtimi do të shërbejnë si bazë shkencore për ruajtjen e biodiversitetit si dhe vlerave tjera të trashëgimisë natyrore në kuadër të pëllgut të lumit Mirushë dhe më gjerë.

Pavarësisht vlerave të biodiversitetit konkretisht fitodiversitetit, rrjedha e lumit Mirushë është nën ndikim të presioneve të ndryshme antropogjene. Këto janë ndikime negative dhe shqetësuese, veçanërisht shfrytëzimi pa kontrollë i vendburimit, ndërhyrjet në shtratin e lumit pa arsyeshmëri profesionale-shkencore, shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtura, hudhja e mbeturinave, vendosja e digave si pikë grumbulluese e ujrave të zeza me ndikim negativ duke e penguar-ngadalësuar procesin e rrjedhjes normale dhe vetë-pastrimit të ujit, biodiversitetin dhe shëndetin e përgjithshëm të lumit si ekosistem natyror.

Në zonën ku buron lumi Mirushë, vegjetacioni dominues është ai i dushkut i cili në aspektin fitosociologjik sipas Braun-Blanquet (Rexhepi, F. 1994) i takon klasës *Quercus-Fagetum* respektivisht rendit *Quercetalia pubescentis* dhe aleancës *Quercion petraeae-cerris* (Krasniqi, E. 2006).

Ndërsa lumi Mirushë vazhduar përgjatë rrjedhës së tij deri në shkarkimin në lumin Drini i Bardhë, kalon nëpër habitate-ekosisteme të ndryshme natyrore dhe antropogjene. Pra, rrjedha e lumit kalon nëpër si ekosisteme pyjore-shkurre, ekosisteme të livadheve si dhe agroekosisteme duke u ndërtuar nga vegjetacion natyror dhe artificial i cili për territorin e Kosovës përmendet edhe nga Rexhepi, F. 1994 dhe Krasniqi, E. 2003.

Me qëllim të paraqitjes së gjendjes sa më reale, materiali floristik është mbledhur me kujdes në periudhën 2023-2024. Janë përdorur metodat standarde për hulumtimin e florës vaskulare sikur edhe në shumë hulumtime paraprake të re alizuara në Kosovë dhe më gjerë.

Duke bërë krahasimin me lumenjt tjerë në Kosovë dhe më gjer, janë vërejtur ngjashmëri mjaft të madhe sikur edhe në hulumtime të ndryshme të realizuara nga autorë të ndryshëm ndër vite (Avdiu,

A. 2012, Bytyçi, P. et al. 2022, Dragusha, A. 2025, Hundozi 1980, Kastrati, R. 2024, Krasniqi, E. 2003, Rexhepi, F. 1982, 1994, Thaqi, L. 2014, Tahiri, R. 2024, etj.).

Duhet përmendur në veçanti se llojet bimore hidrofite janë prezente përgjatë tërë rrjedhës ujore dhe i japin fizionomi tipike të një ekosistemi ujqor i cili njihet si lum Këto janë llojet *Alisma plantago-aquatica*, *Butomus umbellatus*, *Ceratophyllum demersum*, *Lemna minor*, *Potamogeton crispus*, *Potamogeton natans* dhe *Sparganium emersum*.

Sa i përket aspektit fitosociologjik, përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë (Bllacë-Mirushë) dhe në zonën anash rrjedhës së lumit dominon vegetacioni pyjor-shkurre nga pyjet gjetherënëse të dushkut (ku dominojnë llojet e *dushkut-Quercus*), formacionet pyjore shkurore me shëlg (*Salix*) dhe plep (*Populus*) si dhe aty këtu më pak mbulueshmëri kanë formacionet shkurore me kulumri (*Prunus*) dhe murriz (*Crataegus*). Këto lloje dominante shoqërohen nga një numër i konsiderueshëm i llojeve të cilat paraqiten si shoqëruese dhe të integruara mjaft mire në kuadër të mbulesës bimore si *Acer campestre*, *Acer tataricum*, *Clematis vitalba*, *Cornus mas*, *Cornus sanguinea*, *Crataegus monogyna*, *Euonymus europaeus*, *Ligustrum vulgare*, *Lonicera caprifolium*, *Prunus spinosa*, *Robinia pseudoacacia*, *Rosa canina*, *Rubus ulmifolius*, *Sambucus nigra*, *Ulmus campestris*, *Viburnum lantana*, etj. Këto rezultate janë të përafërta me të dhënat nga hulumtimet paraprake në Kosovë të autorëve (Krasniqi, E. 2003, 2006, Rexhepi, F. 1982, 1994 etj.)

Poashtu prezenca e llojeve ialiene invasive në zonën e hulumtuar paraqet diversitet por edhe shqetësim për të ardhmen e florës dhe vegetacionit aktuale.

Me që veprimi negative antropogjen në zonën e hulumtuar është mjaft i theksuar, do të duhej zbatuar ligjet në fuqi me qëllim të jetësimit të mbrojtjes afikase të rrjedhës së lumit i cili juridikisht gëson mbrojtje ligjore.